

RAPORTI VJETOR

Shqipëria ^{*/}

Bazuar në formatin e raportimit sipas aneksit të vendimit I/8

1. **Jepni nje informacion të shkurtër për procesin e përgatitjes së këtij raporti, duke përfshirë informacionin mbi të cilin autoritetet publike janë konsultuar dhe kanë kontribuar në përgatitjen e tij, në mënyrën se si është konsultuar publiku dhe se si rezultatet e konsultimit me publikun janë marrë parasysh në materialin që është përdorur për përgatitjen e këtij raporti.**

Ky raport është përgatitur nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Raporti është diskutuar edhe me ministrin e tjera të linjes si: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Gjithashtu ky raport ka qenë i disponueshëm në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dhe në faqen e Qendres së Informacionit Aarhus dhe i është dërguar për komente OJF-ve.

2. **Raporto rrethana të vecanta që ndihmojnë në kuptimin e raportit, p.sh. nëse ka një strukturë qendrore dhe/ose lokale vendim – marrëse, me të cilën dispozitat e Konventës kanë ndonjë efekt të drejtpërdrejtë që nga hyrja në fuqi ose nëse pamjaftueshmëria e fondeve është një pengesë e domethënëse për zbatim (opsion).**

Ky është raporti i dytë për Shqipërinë dhe institucioni përgjegjës për zbatimin e Konventës është Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, duke përfshirë dhe strukturat në nivel Prefekturë, (Agjensitë Rajonale të Mjedisit). Pamjaftueshmëria e fondeve nga Buxheti i Shtetit e bën zbatimin e Konventës të vështirë, veçanërisht për çështjet që ndikojnë drejtë për drejtë në publikun e gjerë dhe/ose në palët e interesuara e shoqërisë civile.

NENI 3

3. **Listo masave legislative dhe rregulluse dhe masa të tjera që zbatohen dispozitat e përgjithshme të paragrafeve 2,3,4,7 dhe 8 të Nenit 3.**

(a) **në përputhje me paragrafin 2**

Ndërhyrje në kuadrin ligjor

Parimet e Konventës së Aarhus-it janë gjerësisht të pasqyruara dhe të përfshira në Legjislacionin Shqipëtar dhe veçanërisht në:

- Kushtetutën e Republikës
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 8934 dt.05.09.2002 (Neni 3,10, 54, 55, 56, Neni X Neni 77, 78, 79, 80)
- Ligji i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis Nr. 8990 dt.23.01.2003 (Neni 17, 19, 20, 23, 26)
- Në veçanti në të tëra ligjet e aprovuara gjatë kohës 2003-2007;
- Kodi i Proçedurave Administrative
- Ligji për Avokatin e Popullit (Neni 14, 15, 16, 17)
- Ligji i Emergjencave Civile Nr 8756 dt 26.03.2001 (Neni 8.ë)

(b) - **në përputhje me paragrafin 3:** zhvillime pozitive ka patur në Edukimin Mjedisor në Shqipëri këto dy vitet e fundit

SHKOLLA 9-VJECARE

- REC në bashkëpunim me Ministrinë tonë dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës filluan të aplikojnë Paketën e Gjelbër (Green Pack) në shkollat fillore.
- UNICEF në bashkëpunim me MMPAU dhe MASH sapo kanë filluar një projekt “child to child” në shkollat fillore

NIVELI UNIVERSITAR

Në nivelin universitar është krijuar një dege e Inxhinjerisë së Agro-Mjedisit dhe një Master në Shkencën dhe Teknologjinë e Mjedisit, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, departamenti i Mjedisit dhe Ekologjisë.

(c) - **në përputhje me paragrafin 4:**

- Masa e parë administrative është hapja dhe funksionimi i Sektorit IT& Komunikim. Në këtë strukturë është lançuar adresa e postës elektronike personi i kontaktit dhe numri i telefonit, i cili përgjigjet publikut për informacion mjedisor si dhe komunikon me OJF-të si një pikë kyçe për komunikimin midis tyre dhe Ministrisë.
- Në 2005 hyri në fuqi Strategjia dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Konventës së Aarhus-it.
- Ministria ka formuluar the Kërkesën Tip për publikun e interesuar. Kjo kërkesë është e disponueshme në faqen e internetit të Ministrisë.
- Në Shqipëri gjithashtu në këtë vit janë hapur tre Qendra Informacioni të Aarhus-it. Në qytetin e Tiranës kjo qendër është vendosur në katin e parë të Ministrisë së

- Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. Qendra e dytë e informacionit u hap në veri të Shqipërisë, në Rajonin e Shkodrës. Si dhe është hapur Qendra e trete e Informacionit të Aarhus dhe në rrethin e Vlorës
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave ka firmosur një memorandum bashkëpunimi me OJF-të mjedisore më aktive (30 OJF).
 - Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave ka firmosur deklaratën e Komunitetit European për të mbështetur OJF-të mjedisore më aktive.
 - Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave ka mbështetur financiarisht OJF-të në projekte, nga Buxheti i Shtetit. Vetem gjatë vitit 2003, MMPAU ka paguar 1.547.600 Leke, afërsisht 11.459 Euro. Gjatë vitit 2004 projektet e financuara nga MMPAU dhe fondet Hollandeze për OJF-të kanë arritur shumën prej 30.000.100 leke, afërsisht 242.527 Euro. MMPAU në 2005-2006 në bashkëpunim me Hollandën na financuar në projekte 10 OJF , shuma arrinte në rreth 18.300.000 Leke.
- (d) Nuk ka raste kur të jenë kryer ndjekje penale, shqetësime ose penalizime kundrejt personave që kanë ushtruar të drejtat e tyre në përshtatje me Konventën.

4. Përshkruani disa pengesa që janë ndeshur gjatë zbatimit të disa prej pragrafeve të Nenit 3 të listuara më sipër.

- Vihet re mangësi në zbatimin të memorandumit të bashkëpunimit midis MMPAU dhe OJF-ve.

5. Siguroni informacion të mëtjeshëm të aplikimit praktik të dispozitave të përgjithshme të Konventës.

Përgjigje: N/A

6. Jepni adresa interneti nëse janë të disponueshme:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave e Shqipërisë. www.moe.gov.al
Qendra e Informimit Aarhus. www.aic.org.al

NENI 4

7. Listoni masat legjislative, rregulloret dhe Urdhrat që zbatojnë dispozitat për aksesin e informacionit mjedisor në Nenin 4.

- a. *Në përputhje me paragrafin 1* kërkesat e Konventës janë pasqyruar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke i përshtatur në Nene konstitucionale. Si

përfundim, ligji “Për të drejtat mbi informacionin e dokumentave zyrtarë” dhe ligji “Për njerëzit Ombudsman” u aprovuan. Informimi i publikut dhe pjesëmarrja e tij në vendim – marrje, gjithashtu, është trajtuar në Kodin e Procedurave Administrative, në ligjin “për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” dhe në ligjin “Për Emergjencat Civile”. Në të tëra këto akte ligjore, të drejtat për informacion janë siguruar pa një interes të caktuar. Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes në rastet kur ka kërkesë për informacion është caktuar në ligjin “Për të drejtat e informimit për dokumentat zyrtarë” dhe është 40 ditë nga paraqitja e kërkesës. Përgjigjia për këto kërkesa ka qenë e menjëherëshme dhe numri i kërkesave ka qenë i ulët. Numri më i madh i kërkesave vjen nga ardhja e tyre dhe aplikimi për informacion mjedisor në zyrën e Sektorit IT&Komunikim. Në regjistrin e hapur për regjistrimin e tyre rezultojnë 6 – 7 persona në ditë në. Numri më i madh i të interesuarve janë studentë dhe vërtëm 20 % e kërkesave vjen nga OJF. *Një lloj tjetër informimi:* publikimi mjedisor i MMPAU “Bulletini Mjedisor Elektronik” (i përmuajshëm), që pasqyron aktivitetet dhe vendimet kryesore të MMPAU. Faqja e internetit të MMPAU është gjithmonë e për publikun. *Sipas paragrafit 2:* nuk ka patur raste të shtyrjes së afateve kohore mbi një muaj për marrjen e përgjigjeve.

- b. *Në përputhje me paragrafin 3: (paragrafi a)* në rastet kur MMPAU nuk ka informacionin e duhur, i jepet adresa e saktë dhe personin që duhet kontaktuar për të patur informacionin e nevojshëm. *(paragrafi b)* Nuk ka patur raste kur janë bërë kërkesa të paarsyeshme *(paragrafi c)* nuk ka patur raste ku janë kërkuar materiale që nuk janë në juridiksionin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
- c. *Në përputhje me paragrafin 4:* ky lloj informacioni është trajtuar në Nenin 29, paragrafi 2 i ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit” Nr.8934, datë 5.09.2002.
- d. *Në përputhje me paragrafin 5:* në këto raste aplikantët janë informuar menjëherë mbi autoritetet publike të cilët kanë informacionin e kërkuar.
- e. *Në përputhje me paragrafin 6:* nuk ka patur raste të tilla.
- f. *Në përputhje me paragrafin 7:* nuk ka patur raste refuzimi.
- g. *Në përputhje me paragrafin 8:* nuk ka patur shpenzime për marrjen e informacionit.

8. Përshkruani disa pengesa që janë hasur në zbatimin e ndonje prej paragrafëve të Nenit 4.

Përgjigje: N/A

9. Jepni informacion të mëtejshëm mbi zbatimin praktik të dispozitave për aksesin e informacionit, p.sh. a ka statistika të disponueshme për numrin e kërkesave, numri i refuzimeve dhe arsyet e refuzimeve për marrje informacioni?

Në vitin 2007 numri i vizitorëve që kanë kërkuar informacion mjedisor varjon në rreth 625 persona. Rreth 30 % e tyre kanë qënë të interesuar për fushën e Biodiversitetit , për cilësinë e ajrit kanë qënë rreth 40%, 10 përqind në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, dhe 20 % për problemet e mbetjeve dhe peshkimit.

10. Jepni adresa interneti nëse janë të disponueshme:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave e Shqipërisë.
www.moe.gov.al :

ARTICLE 5

11. Listoni masat legislative, rregulloret dhe Urdhrat që zbatojnë dispozitat për aksesin në informacionin mjedisor në Nenin 5.

Në përputhje me paragrafin (1): Autoritete Publike posedojnë dhe perditesojnë informacionin mjedisor janë autoritet vendore dhe lokale.

(i) Së pari, autoritet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe elementët përbërës të saj janë në linjë të parë MMPAU, ARM, Inspektoriati i Mjedisit dhe inspektoriate të tjerë, Këshilli NdërMinistror për zbatimin e Planeve të Veprimit të shëndetit dhe mjedisit.

(ii) Së dyti, autoritete të tjera qendrore me përgjegjësi të caktuara për menaxhimin e burimeve mjedisore, siç janë burimet natyrore dhe mineralet janë në linjë të dytë. Në këtë grup hynë dhe Ministrinë e Linjës dhe strukturat respektive.

(iii) Së treti, janë autoritetet ndër-sektoriale në nivel qendror dhe lokal, të cilat menaxhojnë territorin dhe/ose burimet ujore, vendim – marrja e të cilave lidhet direkt me mjedisin.

(iv) Në raste emergjencash informacioni shpërndahet menjëherë nga Komisioni Kombetar i Emergjencave dhe projektet ndërkufitar.

Në përputhje me paragrafin (3). Faqja e internetit të MMPAU është gjithmonë e disponueshme për publikun, Faqja e Qendres se Informacionit Aarhus gjithashtu edhe faqja e internetit e REC.

Në përputhje me paragrafin (4) MMPAU është e ngarkuar të publikojë Gjendjen Mjedisore në vend dhe të raportojë për të çdo 2 vjet. Raporti i fundit është publikuar në 2003 – 2004 i disponueshëm në kopje të shkruar dhe në internet. Pritet të dali raportimi i fundit i printuar, pasi në rrugë elektronike ai është në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit , Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Në përputhje me paragrafin (5) Si përfundim, ligji “Për mbrojtjen e Mjedisit”, në Nenin 56, të gjitha detajet që lidhen me detyrimet e autoriteteve qeverisëse për ta bërë publik informacionin mjedisor janë të caktuara më gjerësisht.

1. Autoritetet qeverisëse që mbledhin informacionin mjedisor e bëjnë atë publik në mëdita ose në çfarëdo lloj mënyre tjetër, që publiku ta kuptojë.
2. Autoritet qeverisëse, personat fizik dhe ligjorë, sapo marrin lajmin për ndotje apo dëmtim të mjedisit, ata duhet të informojnë publikun mbi impaktin negativ, mbi masat e marra për parandalimin e efekteve negative, në mënyrë që të mbrohen njerëzit dhe që ata të bëhen të ndërgjegjshëm për mbrojtjen e shëndetit të tyre.
3. Blerësit dhe konsumatorët duhet të informohen gojarisht ose me shkrim nga persona fizik ose legal mbi impaktet negative të shërbimeve në lidhje me shëndetin dhe komponentët e mjedisit.
4. Klasifikimi i të dhënave konfidenciale për ruajtjen e sigurisë kombëtare është e administruar në përputhje me këkesat e ligjit Nr 8457, datë 11.02.1999 “Për klasifikimin e informacionit sekret të qeverisës”

Në mënyrë që te kemi një publik të familjarizuar me informacionin dhe kërkesat mjedisore, Sektori IT&Komunikim të MMPAU shpërndajë gratis (pa pagesë) Buletinin Mjedisor, gjithashtu ka tw disponueshëm edhe në faqen e internetit të MMPAU për të tërë publikun e interesuar, etj.

Një tjetër grupim publikimesh janë: “Përmbledhja e legjislacionit mjedisor në Shqipëri”, paketa informuese për çështje të ndryshme (energjit, përdorimi i tokës, legjislacioni, pyjet) dhe dokumenta të tjerë ligjorë që sigurojnë të dhëna për publikun dhe guida për proçdurat. Për shembull, në fushën e mjedisit, dokumentat zyrtarë për aksesin e publikut janë strategji, akte, plane menaxhimi, programe monitorimi, Raporte të Gjendjes së Mjedisit, regjistra përbajtjes, dëshmi dhe raporte të grupeve të inspektimit, të gjitha Direktivat Mjedisore të BE në gjuhën Shqipe “Libri i Kuq” ne kemi publikuar “Zonat e mbrojtura mjedisore në Shqipëri”. Plani i menaxhimit të zonave të ndryshme në Shqipëri (Nartë, Llogora, etj).

Gjithashtu në publikimin dhe informimin për aktivitet e ndryshme kanë kontribuar edhe aktorë të tjerë, veçanërisht REC dhe OJF të tjera si MilieuKontakt Oost Europa Tiranë, Masmedia dhe Mjedisi, etj.

Në përputhje me paragrafin (6) Të tjerë aktorë janë edhe Dhoma Shqipëtare e Tregëtisë dhe Industrisë, të cilët informojnë publikun për aktivitet dhe produktet.

12. Përshkruani disa pengesa të hasura në zbatimin e ndonje pre paragrafëve të Nenit 5.

Mungesë fondesh për publikime të tjera.

13. Siguroni informacion tjetër mbi aplikimin praktik të dispozitave mbi mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mjedisor në Nenin 5, p.sh. a ka statistika të disponueshme mbi informacionin e publikuar?

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave ka publikuar revistën e saj mbi mjedisin, përmbledhje të Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri (shqip dhe anglisht) dhe të tjerë aktorë kanë publikuar fletëpalosje, postera, gazeta ose lloje të tjera publikimesh për raste të veçanta. Nuk ka statistika mbi numrin e publikimeve mbi çështjet mjedisore.

14. Jepni adresën interneti nëse janë të disponueshme:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave e Shqipërisë. www.moe.gov.al

Këshilli i Ministrave : www.kwshilliministrave.gov.al; Dhoma Shqipëtare e Tregëtisë dhe Industrisë: root@ccitr.tirana.al

NENI 6

15. Listoni masat legislative, rregulloret dhe Urdhrat që zbatojnë dispozitat për aksesin e informacionit mjedisor në nenin 6.

Në përputhje me paragrafin (1)

Në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e publikut në procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ligji “Për mbrojtjen e mjedisit” citon:

1. Në procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimit Strategjik të Mjedisit duhet të marrin pjesë dhe grupet e interesuara, veçanërisht autoritetet lokale, publiku në përgjithësi dhe Organizatat Jo Fitimprurëse.
2. Gjatë gjithë procesit të vendim – marrjes, autoritetet përgjegjëse vënë në dispozicion të publikut dokumentacionin e nevojshëm mbi informacionin e kërkuar, brenda një afati kohor të caktuar.
3. Gjatë marrjes së vendimit, autoriteti përgjegjës merr në konsideratë mendimin e autoriteteve lokale, publikut dhe OJF-ve.

Megjithatë, për procese më pak të rëndësishme se Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, siç është kërkesa për draftin e planit të menaxhimit për Zonat e Mbrojtura, ligji “Për Zonat e Mbrojtura” ngarkon MMPAU të marrë në konsideratë “rezultatet që rrjedhin nga bashkëpunimi dhe këshillimi me grupet e shoqërisë civile, veçanërisht me grupet e komunitetit në Zonën e Mbrojtur që është e propozuar si e atillë ose me komunitetin rreth saj, duke përfshirë një përmbledhje të komenteve dhe reagimet e tyre mbi propozimin”.

Në përputhje me paragrafin (2) Në ligjin “Për Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis” kjo ka nisur fazën e zbatimit, duke përfshirë përrfaqësimin e publikut, diskutimet me publikun dhe marrjen parasysh të mendimit të publikut në përputhje me Nenin 6 të Konventës. Neni kërkon përfshirjen e publikut për të vendosur për aktivitete të caktuara, siç janë shprehjet në Aneksin 1 të Konventës dhe aktivitetet të tjera të pa listuar, të cilat mund të kenë ndikim negativ në mjedis. Përdorimi praktik i këtyre kërkesave është objektivi kryesor i MMPAU dhe ARM-ve. Ka disa kohë që i merret mendim komunitetit rreth një

subjekti i cili është në procedurën e marrjes së Lejes Mjedisore. Një diskutim po kryhet me komunitetin e Vlorës dhe grupe të tjera të interesuara për mundësinë e ndërtimit e termocentralit dhe depozitave të karburanteve në bregdet. Bazuar në këtë eksperiencë, priten debate më intensive midis MMPAU, qeverisjes lokale dhe komunitetit në vitet e ardhëshme.

Në përgjigje për çështjen e TEC-it të Vlorë, MMPAU ka ndërmarrë një sërë hapash për të krijuar mundësinë për plotësimin e detyrimeve në lidhje me detyrimet e Konventës së Aarhus-it.

16. Përshkruani disa pengesa të hasura në zbatimin e ndonje prej paragrafëve të Nenit 6.

Nuk ka detaje për procedurën e pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendim – marrjes.

17. Siguroni informacion tjetër mbi aplikimin praktik të dispozitave mbi mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mjedisor në Nenin 6, e.g. a ka ndonjë statistikë apo ndonjë tjetër informacion të disponueshëm mbi pjesëmarrjen e publikut në vendimet e aktiviteteve të veçanta ose për vendime që nuk aplikohen në dispozitat e këtij Neni për propozimin e aktiviteteve që shërbejnë për mbrojtjen kombëtare.

N/A

18. Jepni adresën interneti nëse janë të disponueshme:

N/A

NENI 7

19. Listoni disa masa praktike që janë ndërmarrë për pjesëmarrjen e publikut gjatë përgatitjes së planeve dhe programeve në lidhje me mjedisin. Përshkruani zhvendosjen e përcaktimeve lidhur me Nenin 2 dhe mos – diskriminimin e kërkuar në Nenin 3, pragrafi 9.

Për draftin e paketës legislative, disa OJF kanë marrë pjesë për përgatitjen e tij. Gjithashtu, procesi për përgatitjen e Strategjisë për Zbatimin e Konventës së Aarhus-it ka qenë i hapur për të gjitha OJF-të, që të jepnin mendimin e tyre për këtë çështje. Mbase konsultimi më i gjerë që është mbajtur nga MMPAU për draftimin e Strategjive Kombëtare për Mjedisin (NES).

- 672 Paketa informuese për startegjinë Kombëtare të Mjedisit , 890 CDs dhe 370 versione të printuara të “Draftit të Startegjisë kanë qarkulluar për mendim në nivele të ndryshme të shoqërisë.
- Gjithashtu dhe legjislacioni i ri për pyjet dhe në fushën e parandalimit të ndotjes siç qe asti i hartimit të igjit për Zhurmën ne Republikën e shqipërisë u bënë me pjesmarrjen e gjërë të OJF-ve të interesuar në këtë fushë.

20. Shpjegoni se cilat janë mundësitë për pjesëmarrjen e publikut në lidhje me përgatitjen e politikave lidhur me mjedisin.

Për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Socio – Ekonomik, ne kemi një eksperiencë katër vjeçare në mbledhjen e mendimeve të shoqërisë civile mbi çështjet e mjedisit për këtë strategji. OJF-të dhe grupe të tjera të interesuara për mjedisin janë të ftuara për të diskutuar këto çështje dhe mendimet e tyre do të merren në konsideratë.

21. Përshkruani pengesa të hasura në zbatimin e disa praragrafëve të Nenit 7.

OJF-të mjedisore janë shpesh të pa interesuara në këto procese.

22. Siguroni informacion tjetër mbi zbatimin praktik të dispozitave për pjesëmarrjen e publikut në vendimet e aktiviteteve të veçanta në Nenin 7.

N/A

23. Jepni adresa interneti nëse janë të disponueshme:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e Shqipërisë. www.moe.gov.al

NENI 8

24. Përshkruani se cilat përpjekjet që janë bërë promovimin efektiv të pjesëmarrjes së publikut gjatë përgatitjes nga autoritetet publike të rregullore qeveritare dhe kuadrit tjetër ligjor që mund të kenë ndikim në mjedis. Në shtrirje të përgjithshme, Përshkruani zhvendosjen e përcaktimeve lidhur me Nenin 2 dhe mos – diskriminimin e kërkuar në Nenin 3, pragrafi 9.

Me qëllim vendim – marrjen e Këshillit të Ministrave, veçanërisht kur kemi të bëjmë me Zonat e Mbrojtura dhe importimin e mbetjeve si lëndë e parë për prodhim, mendimi i komunitetit, që jeton përreth zonës, është i detyrueshëm. Një mendim negativ nga komuniteti mund të bllokojë procesin e vendim – marrjes. Komuniteti përfaqësohet nga anëtarët e zgjedhur në Këshillin e Komunës, Rajonit, ose njësi tjetër e administrimit lokal.

25. Përshkruani pengesa të hasura në zbatimin e ndonje pre paragrafëve të Nenit 8.

Mungesa e njohurive legislative të komunitetit, veçanërisht në zonat rurale.

26. Jepni informacion tjetër mbi zbatimin praktik të dispozitave për pjesëmarrjen e publikut në fushën e mbuluar nga Neni 8.

N/A

27. Jepni adresa interneti nëse janë të disponueshme:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e Shqipërisë. www.moe.gov.al

NENI 9

28. Listoni masat legislative, rregulloret dhe masa të tjera që zbatojnë dispozitat për aksesin në drejtësi në Nenin 9.

Legjislacioni i ri ka qenë i kujdesshëm dhe mbështetës për ankesat e drejta të publikut. Për shembull, në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” është nënvizuar: “çdo kush ka të drejtën për t’u ankuar për aktivitet që kërcënojnë, dëmtojnë apo ndotin mjedisin. Dhe që bëjnë kërkesë për mbylljen e aktivitetit në rast rreziku”. Përveç masave të ndërmarra, autoritet janë të detyruar t’u përgjigjen kërkesave, brenda një muaji që nga data e ardhjes së kërkesës. Për më tepër, ky konfirmim është shpjeguar detajisht në një ligj të veçantë, për raste konkrete. Gjithashtu është kompletuar në struktura gjithëpërfshirëse për ankesat administrative.

Për të drejtën mbi informacionin mjedisor ekzistojnë aktet e mëposhtëme normative:

- Kodi i procedurave administrative (neni 20 dhe 51-55)
- Ligji Nr. 8934, 05/09/2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” (Neni 1/2dh, 10/3, 77, 78)
- Ligji Nr. 8503, 30/06/1999 “Për të drejtat e informacionit mbi dokumentat zyrtarë”.

(a) *Në përputhje me paragrafin 1:*

(i) Çdo person që mendon se kërkesa e tij / saj për informacion, pjesë e Nenit 4, nuk është zbatuar në përputhje me dispozitën e këtij Neni, duhet të rishikohet procedura përpara një trupi gjykues. Ai mund t’i kërkojë dëmshpërblim MMPAU ose institucioneve të tjera publike në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit ku ai jeton.

(ii) Ka vetëm një mundësi që Institucioni i Avokatit të popullit të marrë në ngarkim kërkesën. Ky është i vetmi përfaqësues ligjor i cili është pa pagesë. MMPAU nuk ka fonde për të paguar një përfaqësues ligjor (pra personi nuk ka pse të paguajë shpenzimet përpara rishikut nga gjykata) për kërkesën për ankim nga publiku.

(iii) Vendimi i gjykatës për dhënien e informacionit lidhet me institucionin publik, i cili ka refuzuar informacionin.

(c) *Në përputhje me paragrafin 3:* në përputhje me ligjin kombëtar, anëtarët e publikut kanë akses në procedurat administrative dhe ligjore për të kundërshtuar aktet dhe lënien jashtë të personave publikë dhe autoriteteve publike, të cilët shkelin dispozitat e ligjit kombëtar në lidhje me mjedisin, por kriteret që duhen arritur nga publiku nuk janë të përcaktuara sipas legjislacionit kombëtar.

(d) *Në përputhje me paragrafin 4:* nuk ka dallime midis procedurave normale ligjore dhe atyre mjedisore. Ligji parashikon të drejtat bazë për të tëra procedurat në përgjithësi të cilat janë krijuar për të qenë të drejta, me kosto të arsyeshme dhe limite kohore. Vendimet e gjykatës janë të shkruara, publikuara dhe të disponueshme për publikun. Personatë, të cilët kërkojnë dëmshpërblim, marrin një kopje të vendimit të gjykatës.

- (e) Ka përpjekje për informimin e publikut për të drejtat e aksesit të tyre në gjykatë, por nuk ka mekanizma për minimizimin ose përjashtimin e pengesave financiare për këtë qëllim.

29. Përshkruani pengesa të hasura në zbatimin e ndonje prej paragrafëve të Nenit 9.

Akoma nuk ka përputhje midis procedurave ligjore kombëtare dhe kërkesave të Konventës. Zbatimi i Konventës kërkon ndryshime në Kodin Penal, me qëllim futjen e “Krimi kundrejt mjedisit” në këtë Kod. Nga ana tjetër, nënpunësit, gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë të familjarizuar me çështjet mjedisore.

30. Jepni informacion tjetër mbi zbatimin praktik të dispozitave për aksesin në drejtësi në vijim të Nenit 9, p.sh. a ka ndonjë të dhënë statistikore të disponueshme mbi drejtësinë mjedisore dha a ka ndonje mekanizëm ndihmës për të hequr apo për të ulur pengesat financiare dhe pengesave të tjera që ndikojnë për aksesin në drejtësi?

N/A

31. Jepni adresa interneti nëse janë të disponueshme:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave e Shqipërisë. www.moe.gov.al

32. Nëqoftëse është e përshtatshme, tregoni se si zbatimi i Konventës ka kontribuar në mbrojtjen e të drejtave të çdo personi, të gjeneratës së sotme dhe asaj të ardhshme, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij.

Gjate procesit të orientimit në rrugën e demokracisë, publiku dhe Qeveria Shqipëtare kanë identifikuar, me anë të Konventës, të drejtat, detyrat dhe mundësitë e tyre për pjesëmarrje dhe përfshirje. Ata gjithashtu konsiderojnë mundësitë për arritjen e marrëveshjeve dhe vendosjen e bashkëpunimeve, për zhvillimin e alternativave dhe zgjidhjeve për trajtimin bashkëkohor të çështjeve të mjedisit, dhe të kërkojnë mbështetje për synime dhe aspirime thelbësore, jo vetëm për sot, por gjithashtu edhe për të ardhmen.